



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada- Government
Ministria e Drejtësisë
Ministarstvo Pravde/Ministry of Justice

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES TË

MINISTRISË SË DREJTËSISË

DHE

CARITAS KOSOVA

	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.Nr:	<u>01-366</u>
Data / Datum / Date:	<u>23 / 01 / 2014</u>
Shtojca / Dodaci / Annex:	
	PRISHTINË/A

Me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Caritas Kosova, palët nënshkruese (tash e tutje Palët) pajtohen të lidhin këtë Memorandum Mirëkuptimi për ri-integrimin e të burgosurve në shoqëri pas lirimit, e drejtë kjo e garantuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 1
Palët

Palë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi janë Ministria e Drejtësisë dhe Organizata Caritas Kosova.

Neni 2
Qëllimi

Me nënshkrimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi Palët pajtohen për bashkëpunim për periudhë të caktuar kohore me qëllim të zbatimit të projektit të Caritas Kosova: **“Ri-integrimi i të burgosurve pas lirimit”**, brenda Qendrës Korrektuese në Lipjan.

Neni 3
Fushëveprimi

Në bazë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimi, Palët pajtohen që organizata joqeveritare Caritas Kosova, të realizojë aktivitete që kanë për qëllim ri-integrimin e të burgosurve pas lirimit në Qendrën Korrektuese në Lipjan që funksionon në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 4 Obligimet e palëve

1. Me qëllim të zbatimit të Projektit të lartcekur të Caritas Kosova, Ministria e Drejtësisë merr përsipër këto obligime:
 - 1.1 t'u lejoj stafit të Caritas Kosova me seli në Ferizaj, të vizitojnë Qendrën Korrektuese në Lipjan;
 - 1.2 t'u mundësojë stafit të Caritas Kosova kontakte me personelin e Qendrës Korrektuese në Lipjan dhe personat e dënuar në pajtim me dispozitat e ligjit të zbatueshëm dhe rregullave në fuqi;
 - 1.3 Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe personeli i Qendrës Korrektuese në Lipjan do të ju ofrojnë ndihmën dhe informacionin e nevojshëm anëtarëve të Caritas Kosova në lidhje me projektin;
 - 1.4 të njoftoj me kohë Caritas Kosova për ndonjë ndryshim eventual të rregulloreve apo ligjeve të cilat kanë ndikim në implementimin e këtij projekti.

2. Me qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, Caritas Kosova merr përsipër këto obligime:
 - 2.1 që brenda dy javësh nga fillimi i zbatimit të këtij Memorandum Mirëkuptimi të dorëzoj në Ministrinë e Drejtësisë listën e zyrtarëve të saj që do të kenë qasje në Qendrën Korrektuese;
 - 2.2 që me rastin e vizitave në Qendrën Korrektuese në Lipjan stafi i Caritas Kosova, duhet t'i nënshtrohen dispozitave të ligjit të aplikueshëm dhe rendit shtëpiak të Institucioneve Korrektuese;
 - 2.3 të informojnë me kohë Drejtorin e Qendrës Korrektuese, respektivisht Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, së paku 24 orë para vizitës;
 - 2.4 të takohen me Drejtorin e Qendrës Korrektuese në Lipjan para dhe pas përfundimit të vizitës, në rast nevojë edhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
 - 2.5 me rastin e vizitave në Qendrën Korrektuese në Lipjan anëtarët e Caritas Kosova duhet të tregojnë kartën e identifikimit me të cilat dëshmohet se janë anëtarë të Caritas Kosova;
 - 2.6 fuqizimin e kapaciteteve ekzistuese për trajnime në Qendrën Korrektuese në Lipjan;
 - 2.7 përzgjedhjen në bazë të vlerësimit të kapaciteteve të pjesëmarrësve mbi bazën e kriterëve përzgjedhëse (që lidhet me kohëzgjatjen e burgimit);
 - 2.8 ofrimin e trajnimeve për rrobaqepëse dhe floktari;
 - 2.9 trajnimi i trajnerëve të ardhshëm në Qendrën Korrektuese;
 - 2.10 aktivitetet Sportive;
 - 2.11 kampanja për ngritjen e vetëdijesimit, përfshirë këtu lobimin dhe evokimin;
 - 2.12 konferencën e përbashkët me akterët relevant;
 - 2.13 promovimin e të drejtave të njeriut në lidhje me ri-integrimin të të burgosurve;
 - 2.14 të përpilojë raportet mujore, në raste të veçanta edhe raporte pas vizitave të caktuara dhe të njëjtat t'i dërgojë në Shërbimin Korrektues të Kosovës /Ministria e Drejtësisë;
 - 2.15 të përgatis raportin vjetor për aktivitetet që dalin nga ky Memorandum Mirëkuptimi të nënshkruar dhe të njëjtin t'i dërgojë Shërbimit Korrektues të Kosovës

/Ministrisë së Drejtësisë dhe i njëjti të publikohet pas konsultimeve me Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 5

Pjesë e bashkangjitur e këtij Memorandum të Mirëkuptimit është Projekti i Caritas Kosova “ Ri-integrimi i të burgosurve pas lirit”, i miratuar paraprakisht nga Ministria e Drejtësisë.

Neni 6 Kohëzgjatja

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet për një afat tre (3) vjeçar.

Neni 7 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët nënshkruese të këtij Memorandum Mirëkuptimi pajtohen që me mirëkuptim, konsultim dhe negociim të zgjidhin të gjitha çështjet kontestuese që mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 8 Shkëputja

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të shkëputet në çdo kohë, nga cilado palë, duke komunikuar palës tjetër me shkrim paralajmërimin për shkëputjen e Memorandum Mirëkuptimi të tillë së paku një muaj para ditës së shkëputjes.

Neni 9 Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Për: Ministrinë e Drejtësisë:



Përfaqësuar nga

Prof. Dr. Hajredin Kuçi,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë

Për: Caritas Kosova

Përfaqësuar nga

Don Viktor Sopi,
Drejtor Gjeneral

